189:00:00	43.5	43.55	156.6	156.78	-0.18	5.184
190:00:00	43.5	43.55	156.6	156.78	-0.18	5.004
191:00:00	43.5	43.55	156.6	156.78	-0.18	4.824
192:00:00	43.5	43.55	156.6	156.78	-0.18	4.644

Fillimisht është përcaktuar prurja mesatare, e cila rezulton $Q_{mes}=43.55$ l/sek në hyrje të basenit të presionit, që përcillet përmes dy kaptazheve të projektuar. Volumin e kemi projektuar për prurje minimale të burimeve me qëllim që të sigurohet kushtet e një ngarkese të vazhdueshme në tubacion.

Është bërë renditja e vlerave të prurjes duke u nisur nga prurja e cila përgjate 192 orë të simulimit kalon e para vlerën e prurjes mesatare. Kjo vlerë përkon me orën 02:00, $Q=38.95$ l/sek

Llogarisim diferencën e prurjes në hyrje me prurjes mesatare në m^3/sek

$$V=V_{hyrje}-V_{mes}$$

Llogarisim volumin progresiv dhe vleresojmë vlerën më të madhe të volumit përgjate 192 orë e cila rezulton $V=38.41m^3$

Dimensionet në plan të basenit, janë të tilla që baseni të jetë drejtkëndor ku gjerësia minimale

$$B=1.7*D_{II}$$


Ku diametri në dalje të basenit i llogaritur $D_j=406.4mm$

$$B=1.7*406.4mm=690.88mm$$

Dimensionet në plan është pranuar për efekt shfrytëzimi dhe instalimi të pajisjeve $3.5x7m$

Lartësia e Vepres është në funksion të nivelit minimal të ujit në basen, i cili llogaritet si më poshtë :

Kur rrjedha behet në tubacione të gjata me rënje të mëdha ndodh formimi i vrimave lëngu në forme hinke siç është ilustruar në pamjen e mëposhtme :



Lindja e hinkave në lengje zvogelon sipërfaqen e rrjedhës, pra zvogelon prurjen. Gjithashtu aty ku lindin dhe zhduken shkaktojnë pulsime dhe forca të mëdha dinamike.

Thelësia kritike nxirret duke përdorur grafikun e mëposhtem :

Në grafik, kurba a paraqet rastin kur në fund të rezervuarit nuk kemi tubacion, rasti i dytë është ai i cili merr parasysh praninë e një tubacioni në dalje për të cilin jemi të interesuar


Në abshisen e grafikut raporti

$$\frac{v_s}{\sqrt{d}} = \frac{1.24}{\sqrt{0.4}} = \frac{1.24}{0.63} = 1.96$$

Ku V_s shpejtësia në tubacion në rastin e prurjes maksimale në tubacion $Q=150\text{l/sek}$

d diametri i tubacionit

Në ordinate raportin $\frac{H_{kb}}{d}$



Nga grafiku :

$$\frac{H_{kb}}{d} = 1.4$$

$$H_{kb} = 1.4 * 0.4 = 0.56$$

Pra niveli minimal i ujit ne rezervuar nuk duhet te jete me pak se **0.56m** se aksi i tubacionit

Duke marr edhe nje nivel te aksit te tubacionit nga tabani i rezervuarit 0.4m

Me qellim krijimin e volumit te rezervuarit: sipas llogaritjeve te mesiperme na nevojitet nje lartesi e dobishme mbi nivelin

$$H = \frac{V}{S} = \frac{38.41}{24.5} = 1.56m$$

Duke ruajtur edhe nje franko $t=0.8m$ perfundimisht lartesia e Basenit te Presionit rezulton :

$$H=0.4+0.56+1.56+0.8=3.32m$$

Pra perfundimisht rezervuari qe do te ndertohej duhet te kete nje volum :

$$V=3.32*7*3.5=81.34m^3$$

$$Dhe\ volum\ pune\ V=1.56*3.5*7=38.22m^3$$

12.Permasimi i Tubacionit te Transmetimit

Tubacioni i transmetimit shërben për transportin në rrugën më të shkurtër të mundshme nga vepra e takimit deri në deponë e re të qytetit. Nga pikepamja hidraulike ai paraqet një sistem hidraulik tubacioni me presion dhe llogaritja hidraulike për dimensionimin e tyre bëhet duke përdorur marrëdhëniet e njohura për llogaritjen e tubacioneve me presion. Në zgjedhjen e tipit të tubacionit është marrë në konsideratë faktoret që vijojnë :

- Pësha dhe lehtësia në vendosjen në terren e tij
- Kërkesat e mirëmbajtjes dhe jetëgjatësia e pritshme e tij
- Natyra e terrenit ku do të kalojë aksi i tubacionit
- Klima dhe lloji i tokës

Gjate përmasimit të tubacionit të çelikut janë zgjidhur dy parametra të rëndësishëm :

- Diametri është përzgjedhur në mënyrë të tillë që të mundësojë transportin dhe prurjen dhe ruajtjen e një ngarkese minimale piezometrike 4-5m
- Materiali i tubacionit duhet të përballojë presione të larta që lindin (deri në 141kg/cm²) që lindin gjatë situatave më të disfavorshme në kushte shfrytëzimi të ujësjetës. Ndaj është përzgjedhur materiali i çelikut.

Në dimensionimin e tubacionit të transmetimit, është studiuar profili gjatësor i segmentit. Verëhet se terreni për një gjatësi $L=7680\text{m}$ ka një përrësi $i=0.5\%$, e cila më pas ndryshon në mënyrë të theksuar ku për pjesën e mbetur të gjatësisë $L=5623\text{m}$ ka një përrësi $i=17.5\%$

Keto disnivele të konsiderueshme, sugjerojmë që të mund të shfrytëzohen në të ardhmen për prodhim energjie elektrike përmes instalimit të një turbine në pjesën fundore të segmentit. Normalisht kjo alternativë do të kërkonte në hyrjen e turbines edhe instalimin e një pajisje by-pass për shuarjen e energjisë së rrjedhës në momentin kur turbina do të kërkonte mirëmbajtje.

Humbjet për efekt të ferkimit (humbjet gjatësore) në tubacionet me presion llogaritet ekuacioni Darcy-Weisbach si më poshtë

$$h_w = \lambda \cdot \frac{L}{D} \cdot \frac{v^2}{2g}$$

Një tjetër kusht shumë i rëndësishëm për dimensionimin e tubacionit, përveç ruajtjes së një ngarkese piezometrike $H=4-5\text{m}$ mbi tubacion, është gjithashtu edhe shpejtësia në tubacion.

Sipas autoreve të ndryshëm sugjerohen për tubacionet shpejtësite ekonomike si më poshtë :

Per tuba $D=100-300\text{mm}$, $V=0.5-1.0\text{ m/sek}$

Per tuba $D=400-600\text{mm}$, $V=0.8-1.5\text{m/sek}$

Per tuba $D=600\text{mm}$, $V=1-2\text{m/sek}$

Duke patur parasysh keto vlera llogarisim si më poshtë :

Segmenti Basen Presioni-Prog.8720 me gjatesi L=8934ml

Kemi ruajtur nje pjezometer ne fund te ketij segmenti +1794

Llogarisim gradientin hidraulik :

$$i = \frac{1801.54 - 1794.02}{8.934} = 0.84 \text{ m/km}$$

Llogarisim :

Dati di calcolo

D	<input type="text" value="390.59"/>	mm	= Diametro interno
Q	<input type="text" value="52"/>	l/s	= Portata della condotta
J	<input type="text" value="0.84"/>	m/km	= Perdita di carico
C	<input type="text" value="100"/>		= Coefficiente di scabrezza

Perzgjedhim tubacion Dj-406.4mm fillimisht supozojme me spesor =8mm.

Verifikojme shpejtesine :

Dati di calcolo

D	<input type="text" value="390.4"/>	mm	= Diametro interno della condotta
Q	<input type="text" value="52"/>	l/s	= Portata della condotta
V	<input type="text" value="0.44"/>	m/s	= Velocità del flusso

https://www.oppo.it/calcoli/portata_sezione_velocita.html

Kjo eshte vlere minimale e shpejtesise e sugjeruar per mosdepozitimn e materies ne tubacion

Segmenti Prog.8720-Prog.13303, L=4659ml

Ky segment me pjeresi te konsiderueshme, sic e paraqitem me siper, kerkon nje trajtim me specifik. Sipas literatures (V.Milano, "Aquadotti") per tubacionet e linjave te jashtme te cilat karakterizohen nga prurje te vogla dhe disnivele te konsiderueshme, pamvaresisht se sipas llogaritjeve hidraulike rezultojne tubacione te diametrave te vegjel sugjerohet qe keto tubacione te mos jene me te vegjel se 80mm, per arsye te shmangies se bllokimit te tubit si pasoje e hyrjes se gureve ose materieve te ndryshme ne tub.

Duke u bazuar perseri ne vlerat orientuese te shpejtesise kemi :


Dati di calcolo

D	<input type="text" value="257.44"/>	mm	= Diametro interno della condotta
Q	<input type="text" value="52"/>	l/s	= Portata della condotta
V	<input type="text" value="1"/>	m/s	= Velocità del flusso

https://www.oppo.it/calcoli/portata_sezione_velocita.html

Pranoj tubacion çelik **Dj-273mm, -8mm**

Meqenese ngarkesa pjezometrike eshte e konsiderueshme, eshte e domosdoshme shuarja e energjise deri ne hyrje te depos permes instalimit te disa valvulave te presionit me membrane. Qellimi i instalimit te hidrovalvulave per shuarjen e presionit eshte krijimi i nje vije pjezometrike sipas skemes :



Ne kete menyre instalimi i valvulave reduktuese te presionit (PRV) do te realizoje reduktimin e vlerave te presioni P sipas disa parametrave te caktuar deri ne ruajtjen e nje vlere presioni te caktuar ne hyrje te depos.

13 Permasimi i Reduktoveve te Presionit

Dimensionimi i valvulave te presionit realizohet permes dy parametrave:

- Prurja e projektit
- Ruajtjen e nje raporti te presionit ne hyrje dhe ne dalje 2.5 me qellim mbrojtjen nga kavitacioni

Eshte gjithashtu norme gjate projektimit te reduktoreve qe te respektohet shpejtesia e rrjedhes si me poshte:

$V = 0,7 \div 1,5$ m/s (perdorim residenciale) $V = 1 \div 3,5$ m/s (perdorim industrial)

Parashikimi i kavitacionit per valvulat realizohet permes zbatimit te formules:

$$\sigma = \frac{P_1 - P_v}{P_1 - P_2}$$

ku:

P_v =presioni i avujve te ujit ne temperaturen e rrjedhes

P_1 = presioni ne hyrje te reduktorit

P_2 =presioni ne dalje te reduktorit

Sipas llogaritjeve per rezultate si me poshte:

- 2 Nuk kemi shfaqjen e fenomenit te kavitacionit


- 1.7 < <2 Permes pajisjeve mbrotjese mbrohemi prej kavitacionit
- 1.5 < <1.7 Fillon dhe shfaqet kavitacioni
- 1 < <1.5 Kavitacioni ne nivele te larta
- <1 Kavitacion

Diametro Valvola		Range di Portata Raccomandato V= 1.5-5 m/s; 5-17 l/s	
mm	inch	m³/h	gpm
40	1½	6-21	28-94
50	2	11-36	49-166
65	2½	17-57	76-260
80R	3R	17-57	76-260
80	3	25-82	110-375
80L	3L	44-146	196-665
100	4	44-146	196-665
150	6	98-328	440-1,498
200	8	175-584	783-2,663
250	10	274-912	1,224-4,160
300	12	394-1,313	1,762-5,990
350	14	394-1,313	1,762-5,990
400	16	700-2,335	3,130-10,650
450	18	700-2,335	3,130-10,650
500	20	700-2,335	3,130-10,650
600	24	1,575-2,250	7,050-23,970
700	30	1,575-2,250	7,050-23,970
800	32	1,575-2,250	7,050-23,970



Per prurjen e projektit $Q_{min}=52$ l/sek, reduktori i presionit i perzgjedhur DN-200mm

Skema e aplikuar per reduktoret:




Foton e mëposhtme një ilustrim sesi do shfaqen keto skema:




Per cdo PRV te projektuar shperndarja e tyre ne tubacion eshte bere ne baze te disa faktoreve :

- Mundesia e rrugeve te aksesit, me qellim mirembajtjen e tyre
- Reduktimi me qellim arrijten e nje presioni te caktuar ne nje distance te vogel eshte arritur permes instalimit te dy hidrovalvulave PRV te njepasnjeshme, duke bere ne menyre te tille qe PRV te punoje perher brenda vlerave te sugjeruara nga literatura per shmangien e kavitationit. Skema e nje instalimi tip te dy valvulave PRV ne seri eshte si me poshte :



Projektimi i presioneve në hyrje dhe në dalje të çdo hidrovalvule, është përcaktuar nga grafiku :



Rezultatet e çdo hidrovalvule i kemi përmbledhur në formë tabelare:

Diametri i Hidrovalvules	Presioni në Hyrje (atm)	Presioni në Dalje (atm)	Shpejtësia (m/sek)	Progresivi ku do instalohet
DN-200mm PRV-1	16	6	1.66	8+720
DN-200mm PRV-2	6	3	1.66	
DN-200mm PRV-3	12.7	7	1.66	9+400
DN-200mm PRV-4	17.2	7.5	1.66	9+780
DN-200mm PRV-5	14.9	7	1.66	9+940
DN-200mm PRV-6	14.9	7	1.66	10+120
DN-200mm PRV-7	14.9	7	1.66	10+480
DN-200mm PRV-8	16.7	7.5	1.66	11+020
DN-200mm PRV-9	7.5	3	1.66	
DN-200mm PRV-10	12.4	6	1.66	11+780
DN-200mm PRV-11	6	4	1.66	
DN-200mm PRV-12	18.8	8	1.66	13+120
DN-200mm PRV-13	8	6	1.66	
DN-200mm PRV-14	8.86	3.5	1.66	13+280
DN-200mm PRV-15	3.5	1.12	1.66	

Hidrovalvulat nëse instalohen sipas kushteve teknike, nuk kërkojnë mirëmbajtje.

Anet positive të instalimit të hidrovalvulave janë disa, ndër të cilat mund të përmendim:

- Në periudhën e prurjeve maksimale në burime, mund të shfrytëzohet aftësia përcjellese e tubacioneve duke realizuar ndryshimin e vlerave të presioneve në hyrje

dhe dalje të hidrovalvulave, duke përfutur në këto mënyra prurje deri $Q=120\text{l/sek}$, në baza aftësi të përcjellëse të tubacioneve. Kjo duhet realizuar në të gjitha rastet në përputhje me grafikun që përdoren për projektimin e hidrovalvulave, për të shmangur fenomenet e kavitacionit.

- Mundësia e kontrollit në distancë të të gjithë hidrovalvulave përmes instalimit të akuatoreve elektronik, ku mund të bëhet ndjekja e vlerave të presioneve në hidrovalvul në distancë dhe komandimi i tyre në distancë.

14. Llogaritja statike e tubacioneve të çelikut

Llogaritja e spesorit të tubacioneve të çelikut.

Fillimisht, duhet të përcaktojmë fenomenin e grushtit hidraulik.

Levizja quhet e paqëndrueshme dhe me presion atëherë kur në një seksion të caktuar të rrjedhës presioni dhe shpejtësia ndryshojnë në lidhje me kohën. Ky quhet edhe grusht hidraulik sepse shoqërohet me një goditje dhe shtesë presioni.

Shpejtësia e përhapjes së grushtit në tubacion përcaktohet nga formula:

$$a = \frac{V_s}{\sqrt{1 + \frac{\epsilon \cdot D}{E \cdot \alpha}}}$$

Megjithatë në rastin tonë kemi diametra të ndryshëm, do të duhet që shpejtësinë e përhapjes së grushtit ta llogarisim për secilin tubacion, dhe më pas llogarisim një vlerë të përbashkët të përhapjes së grushtit në tubacione përmes formulës:

$$a = \frac{L}{\sum \frac{L_i}{a_i}}$$

Segmenti Basen Presioni-Prog.8720 me gjatësi $L=8934\text{m}$ tubacion çelik $D_j=406.4\text{mm}$ me spesor $\delta=8\text{mm}$.

Llogarisim vlerën e përhapjes së grushtit përmes software:

Fluid data.

Selection of the kind of fluid:

Density of the fluid at 20°C: kg/l

Bulk modulus: GPa

Pipe data.

Selection of the type of pipe:

Young's module of material: N/mm²

Selection of pipe dimensions:

Dimensions of the chosen pipe: Øe (mm) Øi (mm)

Length of the pipe: m

Characteristics of the system.

Intervention time of the valve to the bottom line:

s

Fluid speed in the pipe (v):

m/s

Common values for speed values.


Working pressure:

kg/cm²

Run

Calculation results		
Peak of overpressure (waterhammer)	36.005	kg/cm ²
Total peak pressure	38.005	kg/cm ²
Propagating speed of the shock wave (celerity)	1177.4	m/s
Critical period (phase time) Tf	15.1764	s

Maximum overpressure.



In this chart is shown the trend of the peak of overpressure (Delta P) referred to the intervention time of the valves (v m/s), below the phase time (Tf) the overpressure does not increase. The phase time varies related to the propagating speed of the shock wave which in turn is influenced also by the temperature of the pipe and of the fluid (they have effects of their elasticity modulus), in this calculation we

consider 20 20°C.

<http://www.claredot.net/en/sec-Fluidics/waterhammer-or-peak-of-overpressure.php>

Pra a₁=1177.4 m/sek

Segmenti Prog.8720-Prog.13303, L=4659ml tubacion Dj-273mm -8mm

Data input

Fluid data.

Selection of the kind of fluid: **Water**

Density of the fluid at 20°C: **0.9981** kg/l

Bulk modulus: **2.1** GPa

Pipe data.

Selection of the type of pipe: **User data**

Young's module of material: **206000** N/mm²

Selection of pipe dimensions: **Manual dimensions**

Dimensions of the chosen pipe: **273** Øe (mm) **257** Øi (mm)

Length of the pipe: **4659** m

Characteristics of the system.

Intervention time of the valve to the bottom line:

0.05 s

Fluid speed in the pipe (v):

3 m/s

Common values for speed values.

Working pressure:


2 kg/cm²

Run

Calculation results

Peak of overpressure (waterhammer)	38.208	kg/cm ²
Total peak pressure	40.208	kg/cm ²
Propagating speed of the shock wave (celerity)	1249.4	m/s
Critical period (phase time) Tf	7.458	s

Maximum overpressure.



In this chart is shown the trend of the peak of overpressure (Delta P) referred to the intervention time of the valves (v m/s), below the phase time (Tf) the overpressure does not increase. The phase time varies related to the propagating speed of the shock wave which in turn is influenced also by the temperature of the pipe and of the fluid (they have effects of their elasticity modulus), in this calculation we

Pra a₂=1249.4 m/sek

Vazhdojme llogaritjet:

$$a = \frac{L}{\sum \frac{L_i}{a_i}} \approx \frac{8934 + 4659}{\frac{8934}{1177.4} + \frac{4659}{1249.4}} = \frac{13593}{7.58 + 3.72} = \frac{13593}{11.3} = 1203 \text{ m/sek}$$

Percaktojme fazen e grushtit hidraulik

$$\tau = \frac{2 \cdot L}{a}$$

$$\tau = \frac{2 \cdot L}{a} = \frac{2 \cdot 13593}{1203} = 22.5 \text{ sek}$$

Duke supozuar instalimin e një turbine në fund të tubacionit me një kohë mbyllje $T_m=4$ sek, mund të themi se kur


$$T_m < \tau \Rightarrow \text{kemi grusht të drejtë}$$

Llogarisim shtesën e presionit:

$$P_{\text{shtese}} = \rho \cdot a \cdot V$$

$$P_{\text{shtese}} = \rho \cdot a \cdot V = \frac{1000 \text{ kg}}{\text{m}^3} \cdot \frac{1203 \text{ m}}{\text{sek}} \cdot \frac{2 \text{ m}}{\text{sek}} = 2406000 \frac{\text{N}}{\text{m}^2} = 24.06 \frac{\text{kg}}{\text{cm}^2} = 24.53 \text{ atm}$$

Kete vlere do ta shtojmë në kurben e vijës pjezometrike të tubacionit. Meqenëse llogaritjet janë realizuar duke supozuar vijën statike të tubacionit do të kemi një skemë si më poshtë:



Meqenëse tubacioni është mjaft i gjatë, terreni peson luhajtje të theksuara tubacioni është ndarë në segmente të vecanta, ku vlera e ngarkesës pjezometrike sëbashku me vlerën e grushtit është e ndryshme.

Në kete relacion përmendim procedurën e llogaritjes për një segment, e njëjta procedurë është ndjekur edhe për segmentet e tjera. Përzgjedhim segmentin më me shumë ngarkesë, atë pranë vendit të ndërtimit të depos.

$$P = P_{\text{hidrodinamik}} + P_{\text{shtese}} = 98.9 \text{ atm} + 24.53 \text{ atm} = 123.43 \text{ atm} = 12.1 \text{ kg/cm}^2$$

Spesorin e tubacionit e llogarisim përmes formulës :

$$S = \frac{P_E \times D_E}{2 \times \frac{R_S}{K_3}}$$

Ku :

P_E = presioni maksimal në tubacion, sipas profilit gjatësor, $P_E = 123.43 \text{ atm} = 12.1 \text{ N/mm}^2$

$K_3=2$ (koeficientet sigurie)

S=spesori

D_E = diametri i jashtëm =273

R_S =rezistenca në përkulje e çeliku $R_S=235 \text{ N/mm}^2$

$$S = \frac{P_E \times D_E}{2 \times \frac{R_S}{K_3}} = \frac{12.1 \frac{N}{mm^2} \times 273mm}{2 \times \frac{235N/mm^2}{2}} = \frac{3139.5 \frac{N}{mm}}{235 \frac{N}{mm^2}} = 14.1mm$$

Ketij spesori i shtojme edhe nje vlere $s_0=2mm$ i cili merr parasysh efektin e korozionit. Pra perfundimisht tubacioni i perzgjedhur Dj-273mm me -17.5mm ploteson si kushtet hidraulike per percjellje e prurjes se kerkuar por edhe ate te qendrueshmerise.

Llogaritjet jane perseritur per te gjitha segmentet, te cilat ne menyre te permbledhur I paraqesim:

F.V.Tub çeliku Dj-406.4mm -5mm (L=7330ml,P=49.5kg/ml)
F.V.Tub çeliku D-406.4mm -5.9mm (L=856ml,P=58.3kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-406.4mm -8mm (L=748ml,P=78.6kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-273-mm -8mm (L=1080ml,P=52.3kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-273-mm -11mm (L=750ml,P=71.1kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-273-mm -14.2mm (L=1336ml,P=90.6kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-273-mm -16mm (L=1361ml,P=101.4kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-273-mm -17.5mm (L=164ml,P=110.3kg/ml)
F.V.Tub çeliku Dj-139.7mm -7.1mm (L=26ml,P=23.2kg/ml)

Verifikimi ne qendrueshmeri I tubacionit te çelikut duhet te plotesohet kushti I forces kritike ne vakum qe eshte si me poshte:

$$\frac{D}{\delta} \geq \frac{1}{130}$$

D- Diametri I jashtem I tubacionit


- Trashesia minimale e tubacionit te çeliku

15. Llogaritja e blloqeve të ankerave për tubacionin e çelikut

Ne vendet e ndryshimit të kendeve në planin vertikal dhe planin horizontal të tubacionit të çelikut është e nevojshme të ndërtohen blloqe ankorimi. Llogaritja e blloqeve të ankorimit për kendet në planin horizontal, për kendet në planin vertikal si dhe blloqet për segmentet e drejta me pjerresi të madhe është e ndryshme. I kemi trajtuar në mënyrë të veçantë secilën prej varianteve të paraqitura

A- Ankorimi në kende në planin horizontal

Me qëllim llogaritjen e ankerave në kthesat e tubacionit, fillimisht llogarisim ngarkesën në kthesën e tubacionit sipas një plani horizontal. Sipas skemës së mëposhtme:



Ngarkesa që vepron llogaritet:

$$S = \gamma h \frac{\pi D^2}{4} 2 \sin \frac{\alpha}{2}$$

Ku D: diametri i brendshëm

Me llogaritjen e ngarkesës, kryejmë tre verifikime të nevojshme për ankerin e dimensionuar paraprakisht:

- Verifikim në rreshqitje
- Verifikim të rezistencës së betonit të ankerit ndaj ngarkesave që veprojnë
- Verifikim i aftësisë mbajtëse së terrenit ndaj ngarkesave të ankerit

1. Verifikimi në rreshqitje

Koeficienti i sigurisë v_s i rreshqitjes së bllokut të ankerit llogaritet:

$$v_s = \frac{1}{S} [S_p + f(G_B + G_T + G_A)]$$


Ku G_B = pesha e bllokut të ankorimit

G_T dhe G_A = pesha e segmentit të tubacionit dhe lengut të përfshirë midis seksioneve ekstreme të bllokut

f = koeficient i ferkimit midis bllokut dhe terrenit ne bazamentin e bllokut

S_p = shtytja passive e terrenit perms faqes vertikale te jashtme te germimit

Sipas skemes se forcave:



$$S_p = \frac{1}{2} \gamma_t \lambda_p (H_C^2 - H_B^2) L$$

Ku γ_t = pesha specifike e dheut

$$\lambda_p = \gamma_t g^2 \left(45^\circ + \frac{\varphi}{2} \right)$$

Ku: γ_t = kendi i ferkimit te brendshem

Koeficienti f = sipas autorit Jaki

$$f = \tan(0.9 \varphi)$$

Ne lidhje me koeficientin ν_s pranohet qe vlerat e llogaritura te jene me te larta se $\nu_s \approx 1.1$

2. Verifikimi I rezistences se betonit

Seksioni për të verifikuar është ai I kontaktit midis tubacionit dhe ankerit, me një sipërfaqe $l \cdot D_{Est}$, ku duhet të plotësohet kushti:

$$\sigma_c = \frac{S}{l \cdot D_{Est}} < \sigma_{lejuar}$$

Pranohet $\sigma_{lejuar} = 200 \text{ N/cm}^2$

3. Verifikimi I aftësisë mbajtëse së terrenit

Verifikimi konsiston në raport me sforcimet σ_t të transmetuara nga ankeri në terrenin ku blloku mbështetet, I cili duhet të jetë me I vogël se aftësia mbajtëse e terrenit:

$$\sigma_t = \frac{G_B + G_T + G_A}{A} \leq \sigma_{lejuar \text{ e terrenit}}$$


Ku A është sipërfaqe e mbështetjes së ankerit ndaj terrenit

$\sigma_{lejuar \text{ e terrenit}} = 1.5 \text{ kg/cm}^2$


Thëksojmë se tubacioni është projektuar të instalohet nën tokë me kuote në pjesën dermuese -1.7m. Ky fakt ka ndikuar në dimensionet e blloqeve të ankorimit. Llogaritjet janë realizuar për të gjithë ankerat në format excel, dhe shoqërojnë relacionin

B. Ankorimi në Planin Vertikal

Në këto raste shtytja S bie mbi një plan vertikal paralel me faqet e germimit, ndaj kjo I transmetohet plotësisht bllokut të ankerit. Në varesi të devijimit, sipas ilustrimeve të mëposhtme, ngarkesa S paraqet një drejtim vertikal për sipër ose poshtë



Rasti I brrylave që sjellin rënie të pjerrtësisë



Rasti I brrylave qe sjellin rritje te pjerresise

Duke konsideruar ne menyre te vecante segmentet e tubacionit te perfshire ne seksionet ekstreme , ngarkesa S percakohet njelloj si ne relacionin e pare me siper:

$$S = \gamma h \frac{\pi D^2}{4} 2 \sin \frac{\alpha}{2}$$

Pasi kemi percaktuar me tentative dimensionet e bllokut I cili do te kete si plan simetrie vertikale aksin e tubacionit, rezulton I njohur pasha G_T dhe G_A e lengut me tubin te perfshira midis seksioneve ekstreme te bllokut. Ne kete menyre mund te percaktojme drejtimin e ngarkeses

$$P_V = G_B + G_T + G_A$$

Dhe duke mbledhur dy vektoret P_V dhe S mund te percaktojme ngarkesen maksimale R

Ne kete moment do te realizojme verifikimet e nevojshme te cilat jane:

- 1) Verifikimi I aftesise mbajtese te terrenit
- 2) Verifikimi ne rreshqitje I bllokut

Ky eshte nje nder verifikimet me te rendesishme, ku komponentet vertikale dhe horizontale N dhe T te rezultantes R duhet te plotesojne kushtin:

$$T \leq \frac{1}{\nu_s} f N$$

Ku:


$$f = \text{tg}(0.9)$$

Ne lidhje me koeficientin ν_s pranohet qe vlerat e llogaritura te jene me te larta se $\nu_s = 1$

3) Verifikimi I permbyesjes se bllokut

Nese shenojme me M_R dhe M_S perkatesisht momentet e shkaktuara nga ngarkesa S dhe P_V rrotull pikes "A" do te duhet te plotesohet kushti:

$$M_S = \nu_R M_R$$




C. Ankorimi I segmenteve me pjerresi te madhe

Ne rastet ku pjerresia e terrenit eshte e konsiderueshme pamvaresisht se nuk kemi pranine e brrylave eshte marre ne konsiderate instalimi I ankerave edhe kur tubacioni eshte I vendosur nen toke, pasi ne disa raste forca e ferkimit midis terrenit dhe tubacionit nuk eshte e mjaftueshme dhe nuk e perballon forcen e cila tenton ta rreshqase tubin

Nese konsideroj nje tubacion te perfshire midis dy ankerave neqofte se distance midis tyre eshte L , dhe eshte kendi I inklinimit te aksit te tubacionit, dhe ku h_1 dhe h_2 jane perkatesisht ngarkesat pjezometrike ne dy ekstreme do te kemi:

$$S_x = -R_x = \frac{\pi D^2}{4} \gamma (h_1 - h_2 + L \sin \alpha)$$



Tubacioni tenton të rreshqase vetëm për efekt të $G_T \sin \alpha$, ndërsa I kundërvihet rreshqitjes fërkimi terren-beton përmes forcës $fG_T \cos \alpha$

Koeficient I sigurisë rezulton:

$$\nu_s = \frac{f \cos \alpha}{\sin \alpha}$$

Pranohet koeficienti $\nu_s = 1.5$ dhe nga këtu kemi se:

$$0.3 \cos \alpha = 1.5 \sin \alpha$$

Pra:

$$\tan \alpha \leq 0.2$$

Për këtë arsye për blloket e ankorimit të vendosur nëntokë në zonat me pjerresë të madhe ku tubacioni është I drejtë do të duhet që të parashikohen kur pjerresia e terrenit është mbi 20%. Zakonisht distanca midis blloqeve të ankorimit vendoset çdo 200-300m

16. Llogaritja e vëllimit të depozës së Qytetit Peshkopi

Me qëllim përpunimin e prurjes mesatare orare është e domosdoshme akumulimi dhe shpërndarja me pas në rrjet.

Në mungesë të kurbave të konsumit ditor, llogaritjen e vëllimit e realizojmë në mënyrë empirike përmes formulave të autoreve të ndryshëm.

Me të dhënat e llogaritura përcaktojmë vëllimin e nevojshëm të depozës për plotësimin e kërkesave të furnizimit me ujë :

Funksionet e depozës së akumulimit janë :

- Funksion rregullues i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë së shërbyer

Me qëllim përcaktimin e vëllimit rregullues të rezervuarit V_C shfrytëzohen formula gjysem empirike. Në rastin e sistemeve me ngritje mekanike (sipas V.Milano, "Aquadotti") ky vëllim varion mesatarisht midis 8-15% të prurjes maksimale ditore.

$$V_C = (0.08 \div 0.15) \cdot V_g, \text{ ku } V_g \text{ është vëllimi i ujit të llogaritur për 24 ore,}$$

$$V_C = 0.15 \cdot 4570.56 = 685.584 \text{ m}^3$$

- Funksion rezerve me qëllim përballimin e situatave të avarisë gjatë ndërprerjes së funksionit të ujësjesit të jashtëm. (Avari në tubacionin e transmetimit që furnizon depo).

Probabiliteti i ndërprerjes së furnizimit me ujë rritet me rritjen e gjatësisë së tubacionit, presionit të punës, qëndrueshmërisë së terrenit etj. Vlerat e propozuara të volumit të rezervës nga autoret "Conti" dhe "Zoccoli" (8-12 ore furnizim me ujë)

$$V_r = \left(\frac{1}{3} \div \frac{1}{2}\right) \cdot V_g$$

$$V_r = 0.33 \cdot 4570.56 = 1372 \text{ m}^3$$

$$V = V_c + V_r$$

$$V = 685.58 + 1372 = 2057.58 \text{ m}^3$$

Perfundimisht volumi i rezervuarit $V = 2000 \text{ m}^3$

17. Llogaritja e impiantit të dezinfektimit

Llogaritjet e impiantit të dezinfektimit janë realizuar në përputhje me vendimin Nr.379 Dt.25.05.2016 "Cilësia e ujit ë pijshëm". Në llogaritje si dezinfektues është përzgjedhur si dezinfektant Hipoklorit Natriumi (NaOCl) në formë të lëngshme. Dozimi do të realizohet përmes pompave automatike/manuale, të cilat do të injektojnë dezinfektantin në deponë e akumulimit

Llogaritjet e impianteve të dozimit të NaOCl përfshijnë :

- Llogaritjen e prurjes së pompave të dozimit
- Llogaritjen e volumit të depozitave
- Llogaritjen e pompave të mbushjes së depozitave

Me qëllim zgjidhjen e detyrave të mesiperme përcaktojmë të dhënat :

- Doza e NaOCl për injektim $C = 1 \text{ mg/l}$
- Përqëndrimi i tretësirës dhënë nga pompa e dozimit $S = 13\%$

Formula llogaritëse e dozës së NaOCl të injektuar nga pompa dozuese do të jetë :

$$D = \frac{C \times Q}{S} \left(\frac{l}{orë}\right)$$

Nga sa më sipër Q është prurja e ujit e cila do të dezinfektohet.

Fillojmë llogaritjet :

Prurja e dy burimeve me qëllim llogaritjen e prurjes së dozimit $Q = 52 \text{ l/sek}$

$$D = \frac{C \times Q}{S} = \frac{1 \frac{\text{gr}}{\text{m}^3} \times 187.2 \frac{\text{m}^3}{\text{orë}}}{130 \frac{\text{gr}}{\text{litër}}} = 1.44 \text{ l/orë}$$

Llogarisim volumin e depozitave duke supozuar sipas normave teknike nje ruajtje te NaOCl ne depozita deri **15 ditë**, per arsye te dekompozimit gjate kohes se NaOCl .

$$Q = \frac{W}{t} \Rightarrow W = 1.44 \frac{l}{orë} \times 24orë = 34.56 \frac{litra}{ditë}$$

Duke patur kohen e ruajtjes per 15 dite kemi :

$$V = Q \times 15ditë = 34.56 \times 15 = 518.4 \text{ litra}$$

Me qellim ruajtjen e nje depozite rezerve do të Përzgjedhim 2 depozita me volum V=500 litra material PEAD




Detaj i impiantit të dozimit


Instalimet hidraulike me qellim lidhjen e pompave me depozitat do te realizohet me materiale PVC-U PN16 sipas standarte per transportin e NaOCl

18. Rezultatet e Modelit Hidraulik

Skema e projektuar e ujesjetës është ngarkuar ne software Epanet V.2, ku jane marre si rezultat vlerat e presioneve, shpejtesive dhe ndryshimi I nivelit te ujit ne depo.



Me poshte ecuria e nivelit te ujit ne Basenin e Presionit



Literatura

- 1.Valerio Milano, "Aquadotti", Milano 2000
- 2.Koço Katundi, Rafail Kote, Furnizimi me Uje dhe Kanalizimi I, Tirane 1999
- 3.Raqi Mukeli, Permirosimet Ujore I, Tirane 1973
- 4.Pandi Stratoberdha, Hidraulika dhe Hidromekanika, Tirane 1974
- 5.Gjergji Ikonimi, Hidraulika dhe Hidromekanika, Tirane 1988
- 6.Program simulimit hidraulik Epanet.V2
- 7.Materiale nga internet

Pregatitur nga :

"ERALD - G" sh.p.k

Ing.Gezim ISLAMI

Administratori

Ing.Hid.Ersida VERÇANI

Ing.Hid.Endri PJERO